

UDHËZIM
Nr. 9, datë 14.5.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ADMINISTRIMIT TË
TEKSTEVE SHKOLLORE NË PËRDORIM FALAS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 26 dhe nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të organizojnë punën që në çdo shkollë, në fund të vitit mësimor, të kryhet procesi i vlerësimit dhe i administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas.

2. Nxënësit të dorëzojnë tekstet shkollore të marra në përdorim, sipas aktit të dorëzimit, menjëherë me përfundimin e vitit mësimor. Akti i dorëzimit të teksteve shkollore nënshkruhet nga drejtori i shkollës dhe nga mësuesi kujdestar. Mësuesi kujdestar bashkëpunon/koordinon me prindin e nxënësit apo përfaqësuesin ligjor të tij, për kthimin e teksteve nga nxënësit.

3. Komisioni i Administrimit të Teksteve Shkollore në përdorim falas vlerëson gjendjen fizike të teksteve shkollore të përdorshme dhe identifikon nevojat për tekste shkollore të reja, për të cilat do të bëhet porosia sipas pikës 5, të udhëzimit të MASR-së nr. 24, datë 19.7.2018, “Për dhënien në përdorim falas dhe kthimin e teksteve shkollore për nxënësit e klasave I–IV të arsimit bazë”. Në regjistrin e krijuar nga çdo drejtori shkolle, sipas pikës 12 të udhëzimit të MASR-së nr. 24, datë 19.7.2018, “Për dhënien në përdorim falas dhe kthimin e teksteve shkollore për nxënësit e klasave I-IV të arsimit bazë” ,të plotësohen shënimet përkatëse për çdo tekst shkolle.

4. Numri i teksteve shkollore të vlerësuara si të përdorshme sipas këtij udhëzimi të jetë kriter vlerësimi, pjesë e performancës së institucionit arsimor (shkollës).

5. Shkollat, brenda 10 ditësh nga përfundimi i procedurave, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij udhëzimi, të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, numrin total të teksteve të papërdorshme për çdo titull. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe në MASR.

6. Në rastet kur nevoja për tekste shkollore për vitin pasues tejkalon numrin e teksteve shkollore të kthyera për t'u përdorur, shkolla do të bëjë porositë për tekstet shkollore shtesë, pasi të jetë siguruar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, konfirmimi dhe auditimi i procedurës për çdo shkollë.

7. Shpërndarja e teksteve shkollore të bëhet sipas planit të hartuar nga vetë shkolla, pas procedurës së vlerësimit të gjendjes fizike të teksteve shkollore të kthyera nga nxënësit. Nxënësit e çdo klase të pajisen në të njëjtin përpjesëtim me tekste shkollore të përdorura dhe tekste shkollore të reja.

8. Tekstet shkollore të vlerësuara si të papërdorshme të administrohen dhe të ruhen në shkollë për efekt kontrolli dhe auditimi, sipas udhëzimit të Ministrisë së Financës nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Drejtori i shkollës është përgjegjës për marrjen e masave dhe administrimin e këtij procesi, deri në riciklimin e teksteve shkollore të vlerësuara si të papërdorshme.

9. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të koordinojnë punën për administrimin e teksteve shkollore dhe për plotësimin e kërkesave për tekste shkollore shtesë për të gjitha shkollat në juridiksion të tyre.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të arsimit bazë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini